

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" MSAGE " SH.P.K

Sot, më datë 12.06.2023,

Gentian Hysaj, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 09/11/1973, lindur në Mes, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 033189335 dhe Nr. Personal *H81109112C* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është "**MSAGE**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**MSAGE**" Sh.P.K.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Aktivitete të mirëmbajtjes, lyerje të fasadave dhe tregti e bojrave të të gjitha llojeve, tregtim dhe montim gipsi, tregtim dhe instalime elektrike, tregtim dhe instalime hidraulike, tregtim dhe montim të paneleve diellore.

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**MSAGE**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë


Objektivi i shoqërisë do jetë: Aktivitete të mirëmbajtjes, lyerje të fasadave dhe tregti e bojrave të të gjitha llojeve, tregtim dhe montim gipsi, tregtim dhe instalime elektrike, tregtim dhe instalime hidraulike, tregtim dhe montim të paneleve diellore.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë: Shkodër, Rruga Shetitorja e Molos, Lagjia: Pazar Nr.pasurie 18/104/0 + 1-39/6, zona kadastrale 8591.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **100,000** (Njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë ku kuota ka vlerën 100,000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin "**MSAGE**" Sh.P.K zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Gentian Hysaj, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 25/10/1963, lindur në Mes, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 033189335 dhe Nr. Personal *H81109112C* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% të kapitalit ku një kuotë ka vlerën 100,000 lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori


Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

NENI 9

Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet Z. **Gentian Hysaj**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 09/11/1973, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 033189335 dhe Nr. Personal *H81109112C*, me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi të kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, entë publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.



NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Gentian Hysaj

GENTIAN HYSAJ

